



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	18.07.2025
REFERENC-Ë:	25/2238/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Bardhi - SG" Sh.p.k. Podujevë, eksploatim i gurit gëlqeror, Samadrexhë, Suharekë
CC:	Komisioni për shqyrtimin e kërkesës për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arkivës së MMPHI-së
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për vazhdimin e Lejes Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën me Nr.Prot. 25/2238/MMPHI për vazhdimin e Lejes Mjedisore të operatorit "Bardhi-SG" Sh.p.k. Podujevë, për veprimtarinë: eksploatim i gurit gëlqeror, Samadrexhë, Suharekë.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 25/2238/MMPHI
Datë: 18.07.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafët 1, 2 dhe 4 të nenit 12, nenin 13 dhe nenin 16 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

Aprovohet kërkesa me Nr.Prot.25/2238/MMPHI, e operatorit "Bardhi-SG" Sh.p.k. Podujevë, për vazhdimin e Lejes Mjedisore, për veprimtarinë: eksploitim i gurit gëlqeror, Samadrexhë, Suharekë, në ngastrën kadastrale, nr.P-72116038-00035-0, me sipërfaqe prej 24997 m², zona kadastrale Samadrexhë, Suharekë, sipas Vendimit të Pëlqimit Mjedisor me Nr.:16/3732/1-ZSP/202/16, të lëshuar me datë: 27.10.2016

Operatori obligohet:

- Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
- Të mirëmbahet thurja e ngastrës ku bëhet eksploatimi i gurit gëlqeror;
- T'i përmbahet kushteve të eksploatimit të gurit gëlqeror sipas përshkrimit në aplikacion;

- Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit mjedisor;
- Vazhdimisht të behët spërkatja me ujë e rrugëve të pa asfaltuara të cilat shfrytëzohen për bartjen e gurit gëlqeror nga fusha eksploatuese deri te thërrmimi dhe seperimi;
- Pas përfundimit të aktivitetit të bëhet rehabilitimi dhe rikultivimi i zonës sipas kriterëve ligjore dhe përshtkrimit në aplikacion;
- Nëse gjatë operimit do të këtë ndonjë prishje teknike, e që mund të këtë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI-në.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës me Nr.Prot.25/2238/MMPHI për vazhdimin e Lejes Mjedisore për operatorin "Bardhi-SG" Sh.p.k. Podujevë, për veprimtarinë: eksploatim i gurit gëlqeror, Samadrexhë, Suharekë, në ngastrën kadastrale, nr.P-72116038-00035-0, me sipërfaqe prej 24997 m², zona kadastrale Samadrexhë, Suharekë, sipas Vendimit të Pëlqimit Mjedisor me Nr.:16/3732/1-ZSP/202/16, të lëshuar me datë: 27.10.2016, MMPHI konstaton se operatori plotëson kriteret e parapara me Udhëzim Administrativ 04/2022/MMPHI, për vazhdimin e Lejes Mjedisore.

Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit, NUI 810637134, datë:29.01.2020, të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
- Pëlqim Mjedisor me Nr.:16/3732/1-ZSP/202/16, të lëshuar me datë: 27.10.2016;
- Licencë shfrytëzimi,1695/KPMM/2017, me Nr.Prot.2838, datë:28.06.2017, me kohëzgjatje deri më: 21.12.2025

Andaj, bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), duke u bazuar në nenin 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafët 1, 2 dhe 4 të nenit 12, nenin 13 dhe nenin 16, të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore, merrë vendim që operatorit të larcekur t'i vazhdohet Leja Mjedisore.

Leja Mjedisore lëshohet për periudhën pesë (5) vjeçare, në përputhje me paragrafin 4 të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore.

Leja Mjedisore mund të revokohet, pezullohet apo shfuqizohet në çdo kohë në rast se:

- Pëlqimet apo lejet paraprake mbi bazën e të cilave është lëshuar leja mjedisore janë revokuar, pezulluar apo shfuqizuar;
- Vërtetohet se pala nuk i ka respektuar obligimet e përcaktuara në leje mjedisore;
- Nëse konstatohet se operatori, ka dhënë shënime të pa sakta dhe deklarime të rrejshme;
- Nëse operatori nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të këtij Udhëzimi Administrativ dhe legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Suharekë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së